

## Vendim nr. 6 datë 18.01.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj,	Kryetare
Sonila Bejtja,	Anëtare
Fiona Papajorgji,	Anëtare

në datën 18.01.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 9 (F) 2023 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

**KËRKUESE:** **FATBARDHA SALIAJ**, përfaqësuar nga avokat Olgert Manelli, me prokurë.

**OBJEKTI:** Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2023-3076 (447), datë 12.07.2023 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 4, pika 1, 42, 43, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pika 1, shkronja “i”, 142, pika 1 dhe 145, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 27, 71 dhe 71/a të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Fiona Papajorgji, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

### V Ë R E N:

#### I

#### Rrethanat e çështjes

1. Kërkesja rezulton se është njëra prej trashëgimtareve ligjore të shtetasës S.M., e cila ka qenë një nga paditëset në procesin gjyqësor të kundërshtuar me anë të këtij ankimi kushtetues individual. Shtetasja S.M. bashkë me paditësin tjetër A.R., i janë drejtuar Gjykatës

së Rrethit Gjyqësor Tiranë me kërkesëpadi me objekt deklarimin pjesërisht të pavlefshëm të vendimit nr. 27, datë 01.09.2007 të Zyrës Rajonale të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, qarku Vlorë (*vendimi nr. 27/2007*); detyrimin e të paditurve të njohin paditësit pronarë në disa parcela, duke urdhëruar regjistrimin e tyre në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë (*ZVRPP Vlorë*) në emrin e tyre, si dhe detyrimin e të paditurve të ndërpresin punimet deri në përfundimin e gjykitimit.

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 8709, datë 24.07.2013, ka vendosur pranimin e padisë; anulimin pjesërisht të vendimit nr. 27/2007; detyrimin e të paditurve që të njohin paditësen S.M., si dhe trashëgimtarët e tjerë të shtetasit M.B. pronarë në parcelat respektive; detyrimin e ZVRPP-së, Vlorë të bëjë regjistrimin e pronave në emër të trashëgimtarëve të shtetasve M.B., M.R. dhe S.R., si dhe detyrimin e të paditurve të ndërpresin punimet e ndërtimit mbi këto sipërfaqe toke deri në përfundimin e gjykitimit. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. 3853, datë 25.11.2014.

3. Mbi rekursin e të paditurve Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, me vendimin nr. 00-2023-3076 (447), datë 12.07.2023, ka vendosur prishjen e vendimit nr. 3853, datë 25.11.2014 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, me tjetër trup gjykues. Në datën 07.11.2023 (sipas shënimit të shërbimit postar), kërkuësja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij, i cili, pasi është plotësuar sipas parashikimeve të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 24.11.2023.

## II

### Pretendimet e kërkueses

4. **Kërkuësja**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se është cenuar:

4.1. *E drejta e mbrojtjes dhe e drejta për t'u dëgjuar*, pasi Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë nuk ka njoftuar trashëgimtarët ligjorë të trashëgimlënëses S.M., palë paditëse në proces, për zhvillimin e gjykitimit. Kolegji Civil ka marrë vendim pa praninë e palëve dhe pa u dhënë mundësinë atyre të paraqesin mbrojtjen e tyre. Në këtë rast, Kolegji Civil nuk mund të vendoste për pranimin e rekursit në dhomën e këshillimit pa praninë e palëve.

4.2. *E drejta për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj*, pasi bazuar në përcaktimet ligjore kur është depozituar rekursi (datë 15.12.2014), Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë nuk kishte kompetencë që në dhomën e këshillimit të shqyrtonte

në themel shkaqet e rekursit. Kolegji Civil, ka pasur kompetencë të vendoste mospranimin e rekursit dhe vetëm nëse ai ngrinte shkaqe ligjore sipas nenit 472 të Kodit të Procedurës Civile mund të vendoste kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore.

### III

#### Vlerësimi i Kolegjit

##### A. Për legjitimitimin e kërkueses

5. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

6. Në këtë këndvështrim, kërkuësja, si individ, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të shkronjës “f” të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës “i” të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës, pasi është trashëgimtarja e njëres prej paditësve në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi kushtetues.

7. Një kriter tjetër paraprak lidhet me *shterimin e mjeteve juridike efektive*, i përcaktuar nga neni 131, pika 1, shkronja “f”, i Kushtetutës, sipas të cilit Gjykata bën gjykimin përfundimtar të ankesave individuale kundër çdo vendimi gjyqësor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore kushtetuese që pretendohet se janë cenuar. Në të njëjtën linjë, neni 71/a, pika 1, shkronja “a”, i ligjit nr. 8577/2000 përcakton se mjetet juridike efektive duhet të shterohen nga kërkuesi përpara se ai t’i drejtohet Gjykatës.

8. Kriteri për shterimin e mjeteve juridike efektive nënkupton se kërkuesi duhet të shfrytëzojë paraprakisht në rrugë normale mjetet juridike efektive, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe efikase për një çështje konkrete. Shterimi i mjeteve juridike ka të bëjë me kontrollin subsidiar që ushtron Gjykata, përfshirë edhe rastet e shkeljes së të drejtave të individit. Duke qenë se mbrojtja kushtetuese ka një funksion subsidiar, kjo

do të thotë se mund të kërkohet vetëm për një vendim gjyqësor përfundimtar që përmbyll procesin gjyqësor (*shih vendimet nr. 14, datë 11.03.2021; nr. 29, datë 30.03.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjithashtu, Gjykata ka pohuar se vendimet gjyqësore që kthejnë çështjen për rigjykim nuk mund të konsiderohen si vendime përfundimtare, për efektet e gjykimit kushtetues, pasi ato nuk vendosin në mënyrë përfundimtare për themelin e çështjes. Në të tilla raste kërkuesi i ka të gjitha mjetet e nevojshme juridike për mbrojtjen e interesave të tij gjatë rigjykimit të çështjes, përfshirë më pas edhe mbrojtjen kushtetuese në këtë Gjykatë (*shih vendimin nr. 39, datë 06.07.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

9. Në rastin konkret, Kolegji vëren se kërkuesja i është drejtuar Gjykatës për shfuqizimin e vendimit nr. 00-2023-3076 (447), datë 12.07.2023 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, që ka vendosur prishjen e vendimit nr. 3853, datë 25.11.2014 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, me tjetër trup gjykues, për shkak se gjykatat e faktit kanë gabuar në zbatimin e ligjit procedural, pasi nuk kanë kërkuar nga pala paditëse formimin e drejtë të ndërgjyqësisë pasive.

10. Për sa më lart, Kolegji çmon se në kushtet kur çështja është kthyer për rigjykim dhe procedurat gjyqësore për shqyrtimin e saj nuk kanë përfunduar në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, kërkuesja ka ende mjete ligjore në dispozicion për të paraqitur pretendimet e saj për të drejtat që pretendon se i janë shkelur, prandaj kërkesa nuk plotëson kriterin për shterimin e mjeteve juridike efektive. Për rrjedhojë, analiza e përmbushjes së kriterëve të tjera të pranueshmërisë bëhet e panevojshme, për shkak të karakterit kumulativ të tyre.

11. Në përfundim, Kolegji vlerëson se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “d”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

### **V E N D O S I:**

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.